

IMPLEMENTIMI I STANDARDEVE NDERKOMBËTARE, PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE MËSIMET E NXJERRA.

- “ISSAI DHE ALSAI” -

1.HYRJA

Jo shumë larg, por së paku, tre dekada më parë, në Shqipëri, të flisje e shkruaje për INTOSAI-n, EUROSAI-n dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ishte herezi e rrezikshme dhe e kushtueshme. Kjo sepse deri në vitet e 90-ta ishte instaluar një sistem politik i izoluar, pa asnjë komunikim me botën dhe demokracinë perëndimore, një rrëgjim ekstremisht totalitar e komunist, me kalvarin e burgjeve e të gjenocidit, me vargonjtë e një makinerie të përbindshme të mynxyrave më të pa imagjinueshme. Sikundër do të shkruante historiani gjerman Dr. Ulrich Mahlert , “unë e kam të qartë se në asnjë vend të Evropës Lindore e Qendrore nuk ka patur një diktaturë të tillë kaq brutale si në Shqipëri”.

Nëse do të konsultohet botimi “60 years INTOSAI, 50 years general secretariat”¹, Shqipëria formalisht e *de jure* figuron anëtar i INTOSAI-t që prej vitit 1984 dhe anëtar i EUROSAI-t nga v.1993,² por vetëm në vitin 1997 u vendos në ligj zbatimi i SNA-ve. Kështu, për herë të parë, neni 2, i ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 sanksionoi normën detyruese që, “Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare të kontrollit të përpunuar nga INTOSAI, kontrollon administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në subjektet e përcaktuara me këtë ligj.”

2.-Përfitimet dhe rëndësia e zbatimit të paketës së integruar ISSAI.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, KLSH dhe anëtarët e tjerë të komunitetit INTOSAI-t kanë identifikuar përfitime të shumta të rezultuara nga zbatimi i ISSAI-eve, përfshirë:

- ato janë një shtytës për profesionalizimin e KLSH;
- ata rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e krijimit të një grupi të duhur të politikave dhe standardeve të auditimit në nivelin individual të SAI, dhe sigurojnë bazën e tyre;
- ata mbështesin futjen e funksioneve të reja të auditimit në KLSH.

Udhëzuesit e INTOSAI-t mbi konsideratat strategjike rendisin së paku tre përfitimet esenciale e të mëposhtme nga zbatimi i ISSAI-eve: Cilësia, B.Besueshmëria dhe Profesionalizmi.

¹ -Botim i INTOSAI-t i vitit 2013, faqe 368 e botimit në gjuhën shqipe,

² -Strategjia e zhvillimit të KLHS 2018-2022, Tirane, 2018, faqe 14

3. Rrugëtimi I KLSH me Standardet dhe puna për implementimin e kuadrit të ISSAI-ve.

DEKALOGU I PËRDPJEKJEVE PËR NJË KLSH SIPAS STANDARDEVE ISSAI ...

🏠 **Si hap i parë, KLSH pas ardhjes së Demokracisë, ndryshohet mentaliteti dhe përqafohet e pranohet platforma e aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare të INTOSAI (që zbatohen botërisht) në veprimtarinë e tij audituese.** Këtij procesi i shërbyen: Ngritja e vetëdijes institucionale për nevojën dhe domosdoshmërinë e implementimit të ISSAI-ve , adoptimi i një qasjeje pjesëmarrëse në procesin e zbatimit, krijimi i modeleve për zbatimin e ISSAI, ofrimi i mundësive në përvetësimin e njohurive dhe aftësive të kërkuara mund të jenë disa nga komponentët e menaxhimit të ndryshimit që përdor SAI.

Implementimi i këtyre standardeve ISSAI ka vazhduar në mënyrë graduale, ku procesi i parë është shënuar përmes përkthimit të SNA-ve në gjuhën kombëtare dhe publikimit të tyre. (Paketa e parë e botuar në v.2012 dhe ribotimi i plotë dhe zyrtar i kornizës në v.2016, duke inkuadruar brenda tij dhe Deklaratën e Meksikos (2007), krahas dy Rezolutave A/66/209 dhe A/69/228 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi forcimin e rolit të SAI në promovimin e përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik). Kjo maratonë e botimeve mbi standardet dhe guidat që kanë rrjedhur prej tyre janë ndjekur nga **më shumë se 20 botime** ku mund të veçojmë:

- Botimi i “Standardeve të INTOSAI-t” që në Dhjetor 2012 i hapi rrugën një tërësie botimesh të Udhëzuesve të INTOSAI- ISSAI të niveleve të tjera të cilët do të bëheshin më vonë baza e njohjes me kërkesat e këtyre standardeve nga audituesit e KLSH ashtu dhe palëve të tjera të interesuara.
- Botimi i vitit 2016 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI” është ndjekur nga botime të tjerë të ISSAI-ve, që përcaktohen si tepër të rëndësishëm dhe vendimtar për të mbështetur rrugën e ndryshimit që KLSH ka ndërmarrë në këto vite
- Përkthimi dhe botimi në shqip i standardeve të Zyrës së Auditimit të Shteteve të Bashkuara, GAO (“Libri i Verdhë” në v. 2015), përbëjnë një burim të vlefshëm për dijet mbi auditimin, specifikat e kryerjes së auditimeve dhe do të shërbejnë si udhëzues dhe njohuri shtesë për audituesit e KLSH, ndjekur nga shqipërime e publikime të tjera, si:
- Udhëzuesi për auditimin financiar, V.2012

- Udhëzuesi për auditimin e përputhshmërisë, V.2012
- Standardet e auditimit të borxhit publik, ISSAI 5410-5440, v.2013
- Strategjia INTOSAI 2011-2016 dhe EUROSAI 2011-2017, v.2013;
- Standardet e INTOSAI për mjedisin
- Etika në SAI dhe në institucionet e tjera publike, v.2014;
- INTOSaint,v.2014;
- ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale, v.2014'
- COBIT 4.1, v.2015
- Korniza e Matjes se Performances PFM. V.2017;
- ISSAI 30 dhe udhëzime për implementimin e tij në auditimin e etikës së sektorit publik, v.2017
- GAO, lider i INTOSAI-t, v.2018
- 40 vjet Deklarata e Limës, 2017, etj

Si hap i dytë,


Trajektorja e zhvillimeve për zbatimin në praktikë të ISSAI-ve ka vijuar nga KLSH me **“përvetësimin” e filozofisë dhe të qasjes së re globale mbi vizionin e auditimit shtetëror** dhe misionin e shërbimit vlerë-shtues si shërbëstar i qytetarit. Për këtë, rikonceptuam dhe riformuluam **Vizionin dhe Misionin e KLSH-së** për Implementimin e ISSAI-ve, koncepte që burojnë dhe janë derivate të Misionit dhe Vizionit institucional të INTOSAI. **Vizioni i KLSH-së ka skicuar qëllimet dhe përsosmërinë në implementimin e Standardeve ISSAI.**

KLSH dhe audituesit në kryerjen e auditimit në sektorin publik udhëhiqen nga ISSAI-t dhe qasja e INTOSAI-t për auditimin e sektorit publik.

KLSH konsideron se njohja, implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) përbëjnë një objektiv parësor në funksion të rritjes dhe forcimit të profesionalizmit performancës dhe kredibilitetit institucional.

Përndryshe, Misioni i KLSH-së reflekton detyrimin për të vepruar sipas Standardeve ISSAI

KLSH synon që të ndërtojë dhe zhvillojë një kuadër të plotë dhe gjithëpërfshirës të standardeve të punës audituese, të tillë që të reflektojnë pajtueshmëri me ISSAI-t, të aftësojë dhe pajisë audituesit me njohuritë dhe dijet e nevojshme për kryerjen e auditimeve cilësore, në përputhje me Standardet dhe Praktikrat më të mira Ndërkombëtare të Auditimit Publik.

 **Së treti, miratimi i Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014** “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i mbështetur dhe vlerësuar me nota të larta nga organizmat e BE-së, dhe ekspertët

ndërkombëtarë, si një ligj plotësisht në pajtueshmëri me standardet e INTOSAI-t, shënoi një moment kthese drejt progresit për institucionin e KLSH-së për implementimin e ISSAI-ve. Përmes këtij ligji të ri, KLSH inkorporon konceptet bashkëkohore të auditimit në kontrollin e jashtëm publik të vendit, autorizohet dhënia e opinionit për llogaritë e Shtetit, forcohet pavarësinë e institucionit kushtetues të KLSH-së, hapet rruga për certifikimin e profesionistëve të auditimit shtetëror, etj.

Kuadri i ri ligjor dhe kushtetues zgjeron gamën e auditimeve me lloje e tipologji të reja të përfshira me ligj, të **pa njohura dhe të pa aplikuar gjer atëherë**, (si ato të performancës, të përdorimit të fondeve të BE-së, të teknologjisë së informacionit, të auditimit të mjedisit, auditimet e përbashkëta me partnerët etj). Kështu, u themeluan Departamenti e Auditimit të Performancës dhe ai i auditimit IT dhe për herë të parë iniciohen auditimet e IT (nga 2 angazhime të realizuara gjatë v.2015 dhe 2016, duke mbërritur në **8** auditime në vitin 2018). Kështu startuan dhe morën kuptim në një terren të pashkelur, programimet e auditimeve të performances, (ku për v.2018 numri i tyre mbërriti në **18** angazhime performance).

📄 **Si hap i katërt**, Në përmbushje të misionit kushtetues, dhe plotësisht të angazhuar në përqasjen e tij ndaj standardeve profesionale të INTOSAI-t, në mars të vitit 2013 **Kontrolli i Lartë i Shtetit nënshkroi Marrëveshjen e Angazhimit në kuadër të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (me partnerë IDI - INTOSAI Development Initiative dhe EUROSAI)**, ku palët angazhohen për implementimin e ISSAI-ve, (e njohur ndryshe si Iniciativa për programin e 3i –ve, apo **Programi 3i, osi i-CAT**”), nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Strategjisë së dedikuar për Implementimin e ISSAI-ve³.

📄 **Si hap i pestë**, hartimi i strategjive zhvillimore për KLSH-në dhe monitorimi intensiv i plan veprimeve që rrjedhin nga këto strategji

5.1.-Është konsideruar në vijimësi e rëndësishme për udhëheqjen e KLSH-së të kuptuarit dhe integrimi i këtyre proceseve, duke u

³ **Parimet Udhëzuese për matjen e i-CAT:**

Për të matur ecurinë dhe progresin në zbatimin e kuadrit të normave profesionale inkurajohet përdorimi i i-CAT-seve. I-CAT-të e formuluar si pjesë e programit 3i synojnë të ndihmojnë SAI-të në kuptimin e kërkesave të ISSAI dhe vlerësimin e nevojave të tyre për t'u pajtuar me standardet. ICAT formulohen kështu më shumë si një **mjet i vlerësimit të nevojave**, sesa një mjet i **vlerësimit të shkallës së zbatimit**. Është e rëndësishme që këto rezultate vetë-deklaruese (ashtu si për matricat e SAI-PMF) dhe për i-CAT, përgjigjet e vetëdeklarimit periodik të mbështeten nga provat.

ndjekur nga strategji dhe plane veprimesh që monitorojnë progresivisht dhe periodikisht ecurinë, ku mund të përmendim disa prej këtyre normave:

- ✓ Planifikimi Strategjik i Zhvillimit Institucional 2013-2017
- ✓ **Strategjia e Implementimit të ISSA-ve, (miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH me nr. 58, date 30.6.2015).**
- ✓ Strategjia e menaxhimit të riskut 2015, (rishikuar fundi 2018)
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022,
- ✓ Strategjia e Komunikimit 2017-2019,
- ✓ Raporti i monitorimit të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve (duke filluar nga 2016, dhe çdo vit).
- ✓ Plan veprimet respektive për zbatimin e strategjive

Implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe qasja në auditim sipas praktikave më të mira të institucioneve homologe ishte një nga objektivat kryesore të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017 dhe të rishikuar për pesëvjeçarin 2018-2022, si dhe baza themelore për Strategjinë e Implementimit të ISSAI-ve, konsideruar ky një proces i domosdoshëm i cili synon të transformojë veprimtarinë e KLSH në nivelin e institucioneve homologe të vendeve të BE duke rritur njëkohësisht kontributin në procesin e integritetit të vendit tonë në BE.

Nga ana e KLSH-së, Objektivat Strategjike të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t u integruan në koherencë të plotë në Planin Strategjik duke u formalizuar në objektivat kryesore si: zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH, rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës, zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim, rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit, si dhe rritja e ndikimit të rolit të KLSH-së.

Implementimi i ISSAI-ve afekton procesin e menaxhimit të ndryshimit, që prek disa fusha të rëndësishme për aktivitetin e KLSH dhe që janë domethënëse jo vetëm për ekzistencën por dhe për mbarëvajtjen dhe punën e institucionit sipas parimeve të vendosura dhe kjo përfshin:

- **Kapacitetin institucional**, si mandatin dhe ambientin ligjor në të cilin KLSH operon;
- **Kapacitetin organizativ**, si sistemet, proceset dhe procedurat si dhe burimet që nevojiten për implementimin e ISSAI-ve
- **Kapacitetin profesional** në të cilin përfshihen avancimet si në nivelin drejtues ashtu dhe për stafin auditues.

Në funksion të implementimit të ISSAI, KLSH përcaktoi qëllimet prioritare 2018-2022 mbi këndvështrimet e mëposhtme:

1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6-E.

2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.
3. Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.

5.2.-monitorimi intensiv i strategjive.

Me përparësi, raporti i monitorimit të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve⁴ nga vetë institucioni i KLSH-së.

Kjo strategji është pjesë e programit 3i, dhe nën dritën e këtij programi, Institucionet Supreme të Auditimit anëtarë të IDI (INTOSAI Development Initiative), pjesë e të cilit është edhe institucioni ynë, angazhohen për të implementuar strategjinë, që siguron jo vetëm adoptimin e standardeve, por mbi të gjitha synohet pajtueshmëria në zbatimin e tyre.

a. Gjatë periudhës së implementimit 2015-2017, Strategjia Sektoriale e KLSH është e ndarë në **7 objektiva** dhe aktivitete kryesore duke detajuar më tej me **27 nën objektiva**. Kjo analizë ka nxjerrë në pah nivelin e realizimit për periudhën 2015-2017 dhe me tonë realiste, ka skicuar rrugën për përmirësim dhe zhvillim.

b. Për periudhën 2018-2022 implementimi është i ndarë në **3 qëllime strategjike, që detajohen në 21 objektiva** dhe aktivitete kryesore duke u shtjelluar më tej në **74 nën objektiva**, procese dhe aktivitete, që ndiqen dhe raportohen intensivisht. Secili prej objektivave të strategjisë është zgjeruar në nën objektiva të cilat tregojnë rrugëtimin e detajuar të veprimtarisë për të implementuar strategjinë

Si hap i Gjashtë, vlerësimet e jashtme zyrtare, kompetente dhe autoritare nga Këshilli i Evropës në kuadër të proceseve integruese të vendit.

KLSH i është nënshtruar vlerësimeve të vazhdueshme të jashtme, si pjesë e korpusit të institucioneve të përfshira në Kapitullin 32 të **Progres Raportit të KE**, ku mund të evidentojmë disa nga këto vlerësime:

- **6.1.Raport progresi i KE për Shqipërinë, 26.5.2019**, kapitulli 32 “Kontrolli Financiar”, faqe 99

“Kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (SAI), në linjë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

⁴ -Miratuar me urdhrin e Kryetarit të KLSH nr.123, datë 29.9.2016

(INTOSAI). Megjithatë, ende duhet të sigurohet zbatimi i plotë i kuadrit ligjor” (faqe 98, paragrafi i parafundit).⁵

Në vitet e fundit, SAI ka ndërmarrë masa për të përmirësuar zhvillimin profesional të stafit të tij të auditimit. KLSH po zbaton planin strategjik të zhvillimit 2018-22 dhe strategjinë e komunikimit 2017-19. Cilësia e auditimit duhet të përmirësohet, aktivitetet e auditimit ende nuk i përmbushin plotësisht standardet” (po aty, faqe 98, paragrafi i fundit, faqe 99, paragrafi i parë).

“Në vitin 2018, KLSH dha për herë të parë një opinion mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit 2017. Në qershor të vitit 2018, SAI miratoi një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në rrezik. Numri i auditimeve të performancës u rrit në 18 në 2018, në krahasim me 15 në vitin 2017. ...” (po aty, faqe 99, paragrafi i dytë).

“Raportet e auditimit janë përmbledhur në baza tremujore dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të SAI.” (po aty, faqe 99, paragrafi i tretë).

KLSH ka përgatitur një plan pune të veçantë për zbatimin e rekomandimeve të Progres-Raportit të BE 2019.

○ **6.2.-Raport progresi i KE për Shqipërinë, 2018, kapit. 32, faqe 94**
Pavarësia funksionale, operacionale dhe financiare e Institucionit të Kontrollit Shtetëror (KLSH) është përcaktuar në kornizën ligjore kushtetuese dhe ligjore me standardet e INTOSAI. Zbatimi i plotë i kornizës ligjore do të duhet të sigurohet më tej.

Sa i përket kapacitetit institucional, zhvillimi profesional i auditorëve ka qenë një përparësi në vitet e fundit me mesatarisht 25 ditë trajnimi për auditor në vit. KLSH miratoi planin e saj të auditimit për vitin 2018 sipas metodologjisë së vlerësimit të bazuar në rreziqe. Plani i ri strategjik i zhvillimit për 2018-2022 u miratua në dhjetor 2017. Strategjia për komunikim për periudhën 2017-2019 u miratua në korrik 2017. Sa i përket cilësisë së punës së auditimit, aktivitetet e auditimit duhet të përputhen më tej me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI).

○ **6.3.-Raport progresi i KE për Shqipërinë, 2016, kapit. 32, faqe 86**
Siç përshkruhet në planin strategjik të zhvillimit 2015-2017, KLSH është e angazhuar për të përmirësuar cilësinë e punës së auditimit në përputhje me standardet e INTOSAI. Manualët e pajtueshmërisë dhe kontrollit financiar janë azhurnuar në përputhje me rrethanat dhe aplikimi i tyre po

⁵ www.klsh.org.al, Njoftime: Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në Progres Raportin 2019

vazhdon. KLSH miratoi planin e saj të auditimit për vitin 2016 sipas një metodologjie të vlerësimit të rrezikut.

Si hap i Shtatë, vlerësimet e jashtme nga partnerët dhe institucionet homologe mbi stadin e pjekurisë së institucionit kombëtar të auditimit në zbatimin e standardeve të INTOSAI.

Sfidat për trajtimin dhe përmirësimin e nevojshëm në zbatimin e standardeve mbeten, me kalimin e kohës. Standardet e INTOSAI vijojnë të mbeten vullnetare, pasi pavarësia dhe liria për të zgjedhur standardet dhe për të kryer aktivitetin e KLSH është një gur themeli për ne, si dhe një parim thelbësor i INTOSAI-t. Ky proces gjithashtu inkuadron kryerjen e vlerësimeve **për të matur hendekun midis situatës aktuale dhe pajtueshmërisë**, duke adresuar veprimet e nevojshme për të kapërcyer hendekun dhe përputhur veprimtarinë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Ky komponent u nënvizua dhe në INCOSAI XXIII⁶, ku u theksua se, “drejtimet e ardhshme të auditimit publik varen nga angazhimi i fuqishëm i SAI-eve dhe INTOSAI-t për sigurimin e një mbikëqyrjeje të pavarur të jashtme për arritjet e objektivave kombëtare”.

Për sa sipër, në vitin 2016, Sekretariati i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), Kontrolli i Lartë i Shtetit Shqiptar (KLSH), Gjykata Austriake e Auditimit (GjAA) si dhe Gjykata e Llogarive e Moldavisë (GjLIM) ranë dakord të kryejnë një vlerësim të pavarësisë në një proces rishikimi të jashtëm, (**peer review**) me Vëzhgime dhe lëshimin e një raporti të posaçëm mbi tetë parimet e pavarësisë sipas Deklaratës së Meksikës, (në referencë të **ISSAI 10, 11 dhe 12**).

Veprimtaria e institucionit në lidhje me këtë objektiv është vlerësuar nga ana e Gjykatës së Auditimit të Austrisë, nëpërmjet procesit “**Peer Review**” (**Rishikim mes kolegëve**). Këto gjetje u prezantuan nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, në Konferencën e organizuar me rastin e 40-vjetorit të Deklaratës së Limës mbi Pavarësinë e SAI-ve, në LIMA, Peru më 5 Dhjetor 2017, duke konfirmuar opinionin e vlerësimit se “...**pavarësia, mandati dhe organizimi i ALSAI janë ligjërish de facto të vendosura dhe të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga Ligji i ALSAI-t. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ALSAI-t në vitin 2015, ALSAI pati përmirësime të rëndësishme në pavarësinë e tij krahasuar me parashikimet e ligjit të mëparshëm. korniza ligjore e vendosur**

⁶ iNCOSAI XXIII –Deklarata e Moskës

është e përshtatshme dhe efektive dhe qëndron në pajtueshmëri me Deklaratën e Meksikos”⁷.

Në rastin e Shqipërisë:

KLSH ka përzgjedhur standardet e INTOSAI me ligj si norma profesionale (ne përputhje me përcaktimet e Deklaratës se Limës se 1977 dhe përcaktimet e ligjit organik me nr.154, date 27.11.2014 “Për organizmin dhe funksionimin e KLSH”,

Ligji per KLSH dhe vendi i ISSAI-ve ne kete dispozite ligjore

Neni 14. “Standarde të auditimit” janë një grup konceptesh, parimesh udhëzuese, procedurash dhe metodash, tek të cilat organi auditues bazohet në kryerjen e auditimit

Neni 6/pika 3

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

Si hap i tetë,

Kontributi i KLSH-së në hartimin, rishikimin dhe harmonizimin e normave kombëtare, sekondare dhe terciare për një shërbim auditimi efektiv, që u ndihmojnë praktikave të konsolidimit të reformave në auditimin e jashtëm shtetëror dhe asistojnë energjikisht veprimtarinë audituese. Të tilla janë Udhëzuesit, Guidat dhe Manualet profesionale, (këto për Auditimet Financiare, të Përputhshmërisë, të Performancës dhe Teknologjisë së Informacionit).

Në këtë kuadër, veprimtaria e KLSH-së është fokusuar në **reformimin, përditësimet dhe implementimin e Manualeve të Auditimit Financiar, të Performances, të Përputhshmërisë dhe IT-së.**

Në kuadër të zbatimit të kërkesave të Strategjisë së Menaxhimit institucional 2013-2017 (të ripunuar), të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve dhe të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 Shtylla 6, si dhe në përmbushje të kërkesave të Programit Buxhetor **Triger Matrix**, KLSH hartoi Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit Financiar. Manualet u miratuan nga Kryetari i KLSH-së me 31.12.2015 dhe iu dërguan Delegacionit European dhe SIGMA-s për dhënie mendimi dhe opinionin në funksion të përmirësimit të tyre.

8.1.Manualët e auditimit dhe udhëzimet.

⁷ - Raporti Final i “Rishikimit nga Kolegjet” mb i Pavarësine e ALSAI-t, ACA. Gjykata Austriake e Auditimit, Qershor 2017, Revista “Auditimi Publik” Nr. 16/2017, Seria: Botime KLSH-06/2017/73, fq. 66 parag. 1.3.

Ndërtimi dhe zbatimi i një metodologjie të qartë dhe të aksesueshme është themeli për të garantuar se, auditimet e kryera arrijnë qëllimet e tyre.

- Manualët e rinj të pajtueshmërisë dhe auditimit financiar u pilotuan për herë të parë në vitin 2016. Auditimet e para të IT u kryen në vitin 2016 dhe 2017. Një Kod Etike nga Dhjetori 2016 udhëzon punën e auditimit, në përputhje me direktivat e **ISSAI 30**, (*kjo referuar raport progresit të KE, për v.2018*)
- Përgatitja dhe hartimi i kuadrit metodologjik dhe Manualeve të Auditimit Financiar, të Përputhshmërisë, të Performancës dhe IT ka qenë një provë jo e lehtë, por e suksesshme. Tre Manuale kanë qenë subjekt i rishikimit gjatë periudhës së implementimit të Projektit IPA 2015-2017.
- Gjatë vitit 2018 dhe 2019 u standardizua Rregullorja e Procedurave të Auditimit, si dokument themelor dhe bazik në ndjekjen e ecures së proceseve audituese përgjatë gjithë gjurmës së auditimit, miratuar me vendimin nr. 107, datë 8.8.2017, dhe i ndryshuar.
- Skenari i metodikave dhe guidave kryesore që u janë vënë në dorë audituesve sipas tipologjive të auditimit publik në Shqipëri përfshin **mbi 15 guida dhe manuale, që i shërbejnë zërthimi të panelit INTOSAI GOV në praktikën e punës**, ku mund të përmendim:

Tipologjia e Auditimit	Manuale	Udhëzime dhe të tjera	Gida të reja ose në proces rishikimi
Auditimi Financiar	Manuali i Auditimit Financiar, v.2015	<ul style="list-style-type: none"> - Standardet ndërkombëtare të borxhit publik (ISSAI 5410,11,21,22, 40),viti 2013 - Udhëzues për auditimin financiar. V.2013 - Manual për zbulimin e korrupsionit dhe mashtrimit në auditimin financiar. T.2018 - Udhëzues mbi praktikën e mira të auditimit për financimin publik/privat dhe koncensionet. T.2014 	Udhëzimi i auditimit të buxhetit të shtetit
Auditimi i Përputhshmërisë	Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, v.2015	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzues për auditimin e mjedisit (ISSAI 5110-5140) V.2014 - Manuali i Auditimit të prokurimeve publike. v.2018 	Udhëzuesi SIMMPA

Auditimi i Performancës	Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës, v.2015 Indikatorët e Performancës, 2015	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzues për auditimin e performancës - (ISSAI 3000-3100). - V.2012 	
Auditimi Teknologjisë së Informacionit	Manuali i Auditimit të IT-së, v.2015 Manuali i Auditimit Aktiv të IT-së, v.2018	<ul style="list-style-type: none"> - ISSAI 5310, Metodologjia e rishikimit të sigurisë së informacionit. V.2015 	

8.2.Tools-et dhe mjetet e auditimit janë avancua r, perfeksionuar dhe suportuar nga teknikat e auditimit të asistuar nga kompjuteri.

Duke filluar nga vitit 2018, veprimtaria e proceseve audituese dhe sistemi i informacionit mbështeten nga ana e softuerëve specifik (programi Rev Zonë ose SIMMPA), në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH me nr.151, datë 29.10.2018 i ndryshuar. Aplikimi i këtij programi ka ndihmuar në cilësinë e auditimeve, dhe i ka shërbyer **jetësimit të ISSAI 200⁸ (kërkesat e paragrafit nr. 143) dhe ISSAI 400⁹** mbi hartimin e opinionëve të auditimit bazuar në dëshmitë e besueshme dhe të mjaftueshme dhe për të gjykuar në se pasqyrat financiare të entiteteve publike të audituara dhe veprimtaria e tyre është në përputhje me kriteret dhe kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar apo të përputhshmërisë ligjore.

8.3.-Intensifikimi i proceseve të Zbatimit të Rekomandimeve, në frymën e Parimit nr. 7 “Ekzistenca e mekanizmave efektivë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve”, të Deklaratës së Meksikos¹⁰.

Në udhëzimin nr.1, datë 04.11.2016 “*Për procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, u reflektuan përmirësimet që ka pasuar kuadri rregullator dhe funksional i KLSH-së, përmirësimi i metodologjisë audituese dhe nga implementimi i standardeve ISSAI. Në këtë udhëzim u reflektua gjithashtu eksperiencia e akumuluar nga KLSH, si dhe konkluzione të bashkëpunimit me ekspertë të projektit IPA, SAI-t homologe dhe angazhimi në veprimtari ndërkombëtare të INTOSAI-t,

⁸ -Parimet themelore të auditimit Financiar

⁹ -Parimet themelore të auditimit të Përputhshmërisë.

¹⁰ -ISSAI 10, miratuar nga INCOSAI XIX, 2007, Meksikë

ECA-s dhe SIGMA-s.

8.4.Sigurimi i cilësisë.

Sigurimi i Cilësisë (**ISSAI 40**) ka krijuar mundësitë për një proces të analizës kritike e të nevojshme , në funksion të përmirësimit të aktiviteteve me qëllimin përafrimin e veprimtarisë audituese sa më afër përmbushjes së standardeve të pranuar, duke i shërbyer në këtë mënyrë forcimit të besueshmërinë në çdo rezultat dhe raport të publikuar nga KLSH.

1. *Kontrolli i cilësisë si proces i formalizuar me filtrat dhe nuklet e zinxhirit të cilësisë dhe të vlerësimit dhe përmirësimit të raporteve të auditimit (nivele kryeaudituesi, departamenti auditimit, dep. i sigurimit të cilësisë dhe drejtori i përgjithshëm pastaj shprehet kryetari KLSH. Kështu, gjatë vitit 2019 janë kontrolluar dhe dhënë mendime për **138 auditime**, ku trajtohen dhe mangësitë e shfaqura në procesin auditues lidhur me informacionin paraprak për subjektin që auditohet, dokumentimin e procedurave dhe aplikimin e teknikave të përshtatshme të auditimit, etj.*
2. *Shtimi i filtrave garantues të cilësisë brenda departamentit, duke rritur komunikimin mes kolegëve dhe ngritur grupe që certifikojnë punën e njëri-tjetrit;*
3. *Aplikimi i proceseve të kontrollit të cilësisë **në vijimësi, në të nxehtë dhe në te ftohtë** (rreth 30 % e fondit të auditimeve të evaduar nga viti i mëparshëm kalendarik kalojnë në siten e një komisioni ekspertize për vlerësimin e cilësisë së tyre, duke arritur në konkluzione dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë audituese të KLSH).*

Në procesin e përmirësimit të politikave të auditimit, është hartuar dhe miratuar nga KLSH, udhëzuesi mbi menaxhimin e cilësisë së auditimeve gjatë v.2019.

Si hap i nëntë,

KLSH është impenjuar në shkëmbimin e përvojave ndërkombëtarisht, përmes pjesëmarrjes në tryezat e grupeve të punës së EUROSAL dhe INTOSAL-t; kryerjes së auditimeve pilote, paralele dhe të përbashkëta me SAL partnere; Më konkretisht,

9.1 -KLSH i referohet në përditshmërinë e saj motos së INTOSAL-t, se “nga përvojat e përbashkëta përfitojnë të gjithë”. Nën këtë okeljo, KLSH ka konsideruar primare shkëmbin ndërkombëtar të eksperiencave, sipas definimeve të **nenit 15 të ISSAI 1**, si një pjesëtar aktiv nëpërmjet kontributeve dhe **angazhimit në grupet e punës së EUROSAL-t dhe në takimet rajonale** me dobi të përbashkët. P.sh:

“-Takimi i XII i EUROSAT IT Working Group, zhvilluar në datat 11-13 Prill 2018 në Tallin të Estonisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 36 SAI-e anëtare të EUROSAT.

-Grupi i Punës për auditimin e fondeve të alokuara për Katastrofat dhe fatkeqësitë natyrore, zhvilluar më 29-30 mars 2018, si pjesë e Takimit të IV-t vjetor të Grupit të Punës së EUROSAT-t për "Auditimin e fondeve të alokuara për katastrofat dhe fatkeqësitë natyrore", zhvilluar në Moldavi.

-Grupi i Punës për Auditimet e Mjedisit (në Helsinki të Finlandës dhe në Bratislavë të Sllovakisë).

-Grupi i Punës mbi Auditimin dhe Etikën, i zhvilluar në Lisbonë, si takimi i IX-të i grupit Task Force të EUROSAT-t për "Auditimin dhe Etikën";

-Grupi i Punës i EUROSAT për Auditimin e Bashkive, me takimin vjetor të anëtarëve të Task Forcës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive (TFMA) dhe Seminarin për Auditimin e Bashkive, në Beograd. etj.

✓ **9.2-** KLSH në fund të vitit 2016, përmbushi kryerjen e **13 auditimeve pilot** konform detyrimeve të përcaktuara nga **Matrica e zbatimit të programit buxhetor të Strategjisë së Menaxhimit të Financave publike**, duke reflektuar në Manualet të gjitha problematikat e rezultuara nga procesi i testimit, nën frymën e direktivës që përçon **Guida e INTOSAT-t - 5203** – “Bashkëpunimi në Auditimin e Akordeve Ndërkombëtare të Mjedisit”:

- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të KLSH-së në iniciativën e bashkëpunimit midis Institucioneve të Auditimit Suprem (SAI) në auditime paralele të performancës, **PPA II. (Paralel Performance Audit) Shkup, Maqedoni**, në vijim të bashkëpunimit të vendeve të rajonit në auditime paralele performance e iniciuar për herë të dytë nga SNAO Suedi (Paralel Performance Auditim PPA II).

- **Auditimi i Cilësisë së Ajrit** u realizua në kuadër të auditimit paralel ndërkombëtar “EUROSAT -Cooperative Audit on Air Quality”, i cili udhëhiqet nga SAI i Holandës në bashkëpunim me SAI e Polonisë, ku marrin pjesë 16 SAI nga vende të ndryshme të Europës;

- Duke patur parasysh rëndësinë e që **Zonat e Mbrojtura Detare kanë për vendet e tyre**, Institucionet Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Qipros, Greqisë, Maltës dhe Portugalisë, në cilësinë e anëtarëve të EUROSAT-t dhe Grupit të Punës për Auditimin e Mjedisit (EUROSAT WGEA), vendosën të ndër marrin një auditim të përbashkët me qëllim shqyrtimin e mekanizmave të aplikuar nga këto vende për të siguruar menaxhimin adekuat dhe efektiv të Zonave të Mbrojtura Detare brenda juridiksionit të tyre. Auditimi është zhvilluar përgjatë vitit 2018 dhe është koordinuar nga SAI-t e Qipros dhe Maltës.

Si hap i dhjetë,

KLSH demonstroi profilin e lartë të shërbëtarit për qytetarin, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të veta dhe vlerësimit të impaktit social të auditimeve të kryera.

- ✓ **10.1-Pritshmëritë e palëve të interesit dhe impakti social i auditimeve** - Në skicimin e rrugës dhe projeksioneve të së ardhmes, KLSH ka mbajtur parasysh pritjet e aktorëve të ndryshëm, legjislativit, qytetarëve, entiteteve të audituara, medias, shoqërisë civile dhe botës akademike, etj.

10.1.1• Parimet e transparencës dhe llogaridhënies së KLSH (ISSAI 20 dhe shembuj të dhënë në përmbushjen e ISSAI 21) – janë konsideruar jo vetëm si parimet themelore, por dhe si praktika të mira, të inkurajuara fuqimisht për zbatim nga KLSH në kuadër të përmbushjes së funksioneve dhe obligimeve kushtetuese.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucioni më i lartë ekonomiko-financiar është udhëhequr nga parimi i përmbushjes së detyrimeve kushtetuese duke vepruar si **agjent i Kuvendit** për të siguruar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e parasë publike nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale.

Me atë të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit, KLSH përveç përmbushjes së detyrimit kushtetues të **raportimit për zbatimin e buxhetit faktik nga Qeveria dhe raportimit mbi performancën e institucionit** ka synuar informimin e Kuvendit edhe përmes raporteve të veçanta të cilat paraqesin rëndësi të veçantë për publikun. Kështu, në akordancë me **ISSAI 12**, “Vlera dhe përftimet e SAI-ve – të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve” dhe në respektim të plotë të **neneve 8 dhe 16, të ISSAI 1 “Deklarata e Limës”** (me udhëzimet për rregullat e auditimit) që njeh se SAI duke garantuar autonominë vepron si bashkëpunëtor i legjislativit, nga ana e KLSH-së i janë përcjellë Kuvendit të Shqipërisë vetëm gjatë vitit 2017, **18 Raporte auditimi të kryera gjatë vitit se bashku me vendimet e Kryetarit të KLSH-së për evadimin e tyre.**

- Në përmbushje të detyrimeve që KLSH ka në zbatim të këtij dokumenti, KLSH ka raportuar në janar **2019 për statusin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2017**, për të cilin KLSH ka hartuar planin e veprimit për zbatimin e kësaj rezolute.

10.1.2. Partneriteti me median për të prezantuar auditimin e sektorit publik.

- Transparencës institucionale i ka kontribuar dukshëm edhe **prezenca e audituesve të KLSH-së në median e shkruar, shkrimet e të**

cilëve i janë paraqitur të përmbledhura publikut në **11 volume (periudha 2013-2018)**, të cilët janë botime të kolanës së KLSH-së. Shkrimet e audituesve përmbajnë gjithnjë e më shumë shkrime konkrete për problematikat që hasen më shpesh në jetën e përditshme të qytetarit që merr shërbime publike, por dhe që janë më të mprehtat, të cilat janë evidentuar në auditimet e kryera prej tyre.

- Gjatë vitit 2018, ne kemi qenë **prezentë pothuajse në të gjitha organet e shtypit të shkruar** me 121 shkrime, të shkruara nga auditues të KLSH-së. Gjatë gjashtë viteve, 2013-2018 audituesit e KLSH kanë botuar 642 artikuj

10.1.3.-Kontrolli i Lartë i Shtetit është një nga institucionet më të hapura ndaj ankesave të qytetareve, të cilat adresohen me postë të zakonshme ose elektronike. Të gjithë **letër- ankesat e qytetareve** administrohen me prioritet nga stafi auditues i KLSH-se ne funksion të tematikës që trajtojnë. Në çdo rast qytetaret marrin përgjigje për shqetësimin e ngritur me përjashtim te rasteve kur heshtjet e ngritura janë jashtë kompetencave të institucionit. Theksojmë që në vitet 2010, 2011 trajtoheshin mesatarisht 65 letra në vit, 10 herë më pak se në vitin 2017.

10.1.4.-Transparenca me qytetarin:

Gjatë vitit **2018, në zbatim të ISSAI 20**, jane vendosur në WEB, në kuadër të rritjes së transparencës vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për auditimet e realizuar përgjatë vitit 2018, në masën 81% (janë vendosur **126 vendime auditimi nga 156 auditime të realizuara**) dhe janë vendosur gjithashtu edhe **40 raporte auditimi**). Janë pasqyruar dhe hedhur në web në vitin 2017 pothuajse të gjitha Vendimet e Auditimit, 153 auditime nga 156 të realizuara (98%) dhe 152 auditime nga 154 të realizuara për vitin 2016 (98.7%).

10.1.5.Gjatë shtatë viteve të fundit KLSH ka nënshkruar **57 marrëveshje bashkëpunimi**, nga të cilat 30 me OJF, 17 me institucione homologe dhe 10 me institucione shtetërore dhe Universitete publike e private.

10.1.6.Viti 2018 ishte viti i tretë radhazi që Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi **“Muajin e Hapur”** dhe kjo tashmë mund të konsiderohet si një traditë institucionale. Gjatë muajit të hapur u zhvilluan **54 aktivitete** të ndryshme.**Kolana e botimeve të KLSH-së** është shtuar gjatë viteve të fundit me tituj gjithnjë e më cilësorë

✓ **10.2- Forcimi i kapaciteteve profesionale:**

Kuadri i ngritjes së kapaciteteve përpiket të tregojë një pamje të kapaciteteve që duhet të ketë KLSH për të qenë në gjendje të gjenerojë vlerë për palët e interesuara. Kapitali human, audituesit mbeten aset më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm për KLSH-në duke konsideruar që suksesi në përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të saj varet

në mënyrë të ndjeshme nga të krijuarit të një trupe auditimi kompetente dhe të mirëtrajnuar. Në këtë kontekst, politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore, të KLSH përfshijnë nëntë elementët e përmendur në zbatimin e udhërrëfyesit brenda Kontrollit të Cilësisë për SAI-t, **ISSAI 40, duke i dhënë rëndësinë e duhur cilësisë dhe angazhimit të KLSH ndaj parimeve etike.** Nëpërmjet këtyre elementeve theksohet domosdoshmëria e kulturës së edukimit të vazhdueshëm nga audituesit, e cila synon të:

- ✓ Rekrutimi, kultivimi, monitorimi dhe promovimi vetëm në përputhje me dijet e audituesve dhe kontributin profesional në punën audituese;
- ✓ Trajnimi dhe testimi sipas një kalendari dhe kurrikule të planifikuar në terma vjetorë, të specializuar në përputhje me eksperiencën dhe fushën audituese, të harmonizuar me trajnimet e tjera brenda e jashtë vendit;
- ✓ Ndryshimi i qasjen së audituesve nga reaktive në proaktive;
- ✓ Shfrytëzimi i ekspertizës vendase dhe të huaj në dobi të auditimit dhe jo anasjelltas
- ✓ Realizojë mesatarisht **25 ditë trajnimi në vit për çdo punonjës** të institucionit suprem të auditimit, duke matur njëkohësisht impaktin e këtij sistemi në përfomancën e punës audituese.

Në këtë pikë, meriton vëmendje:

10.2.a. Përmirësimi i Udhëzimit mbi rritjen e kapaciteteve audituese dhe të cilësisë në auditim. Udhëzimi i KLSH nr.2, datë 30.12.2016 ka ardhur si një përmirësim i udhëzimit të vitit 2012 për të promovuar dhe mbështetur zhvillimit profesional dhe individual të audituesve të KLSH-së. Qëllimi është forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit të KLSH-së, duke orientuar zhvillimin dhe promovimin e vazhdueshëm profesional të audituesit. Ky Udhëzim, është matuar nga Dokumenti i Politikave të Burimeve Njerëzore dhe synon të promovojë **zhvillimin profesional i audituesve të KLSH-së**, në një linje me standardet e INTOSAI. Në këtë pikë, forcimit dhe ngritjes së kapaciteteve të auditimit të KLSH, i ka shërbyer implementimi i **Projektit të Binjakëzimit** i financuar nga Bashkimi Evropian **gjatë periudhës 2016-2018.**


10.2.b. Zhvillimi i metodologjisë së planifikimit vjetor në auditim duke reflektuar kërkesat e ISSAI-ve përkatës për këtë qëllim, proces ky i cili u realizua nëpërmjet eksperteve të IPA-s përgjatë vitit 2016 për planin e veprimtarisë audituese të vitit 2017. Sa sipër, është miratuar Udhëzimi i Kryetarit të KLSH me nr. 4, datë 31.12.2015 “Për hartimin e planit vjetor të auditimit të KLSH bazuar në vlerësimin e riskut”.

Mund te konfirmohet që i gjithë procesi i implementimit të standardeve profesionale te auditimit është shoqëruar me trajnime intensive mbi: *standardet ISSAI, Manualet e Auditimit, rregulloren e procedurave të auditimit , rregulloren e brendshme, strategjitë e zhvillimit., etj .*

Në lidhje me trajnimet, seminarët dhe workshop-et e ndjekura jashtë vendit nga stafi auditues dhe drejtues i KLSH dinamika e treguesve është e tillë: Vetëm gjatë 5 viteve të fundit kanë marrë pjesë në trajnime, seminare e workshope, grupe pune e konferenca, etj. **654 auditues dhe drejtues**, të inkuadruar në **264 aktivitete**.

Internship-et janë konsideruar një mjet eficient për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së. Në total janë **23 auditues** të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA. Bashkëpunimi i suksesshëm i iniciuar prej vitit 2012 me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA ka vazhduar me pjesëmarrjen të audituesve tanë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre dhe aktualisht e kanë përfunduar këtë program **6 auditues**

Analiza grafike dinamike e procesit të trajnimeve 2009-2019 1shtë e këtillë:



Ecuria e procesit të trajnimeve profesionale si dhe zhvillimi i tyre gjatë vitit 2019, është udhëhequr nga Standardi Ndërkombëtar i Auditimit **ISSAI 12/ (Parimi nr.12 / 1**, i cili përcakton se, “SAI duhet të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm profesional që kontribuon në përsosjen:


- ✓ Organizative;
- ✓ Individuale dhe
- ✓ Ekipore”

Treguesi kryesor i progresit reflektohet në rritjen e numrit të trajnimeve që çdo auditues ka kryer gjatë vitit, duke arritur një **nivel të kënaqshëm** prej **3611 ditë njerëz trajnime, ose referuar 145 audituesve efektive vjetorë, rezultojnë 25 ditë trajnimi mesatare vjetore per auditues** në vit, (kundrejt **2.1** të arritura në 2011 dhe **3.1** ditë trajnimi/person të kryer në vitin 2010).

- ✓ Arritja e një numri mester prej 25 ditë trajnimi për çdo auditues

shënon një rritje me **12 herë** kundrejt vitit 2011, kur ky tregues ishte minimal.

Dinamika e trajnimeve te KLSH per periudhen 2009-2019:



SFIDAT PER TE ARDHMEN....

Në përfundim, theksojmë që Implementimi i standardeve ISSAI është një proces dinamik, pasi dhe vetë zhvillimi i standardeve profesionale të auditimit është i tillë, kjo në përgjigje dhe reflektim te shndërrimeve ne nivel global.

E parë në këtë këndvështrim, implementimi i standardeve profesionale do të vijojë të konsiderohet si një prej prioriteteve jetësore për institucionin e KLSH. KLSH riafirmon angazhimin konstant në zbatimin e kuadrit të plotë të INTOSAI-t dhe për sa sipër, prioritetet do të synojnë:

- ☞ Realizimin e rregullimeve ligjore dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme audituese me burimet e duhura, për të t implementuar Kuadrin e ISSAI-ve në mënyrë cilësore dhe me qëndrueshmëri afatgjatë.
- ☞ Vendosja një Sistemi të Certifikimit të Audituesve të Jashtëm Publik, duke përmirësuar kuadrin ligjor mbështetës për këtë qëllim. Sistemi i certifikimit ndërtohet duke marrë në konsideratë eksperiencën e GAO-s, si dhe eksperiencia të tjera të ngjashme të vendeve të BE, siç është eksperiencia e SAI-t Kroat.
- ☞ Zhvillimi i një Programi për Certifikimin e Audituesve në formën e moduleve të strukturuar dhe duke aplikuar kurse praktike të dedikuara brenda KLSH-së si dhe në bashkëpunim me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit apo me organizma të tjerë të profesionit. për kultivimin dhe shpërndarjen e dijeve dhe njohurive të profesionit të auditimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- ☞ Zhvillimin e kapaciteteve për rishikimin periodik të metodologjisë dhe formateve standarde të auditimit, që të garantojnë përputhshmërinë në çdo kohë me SNA, si dhe për ofrimin e

asistencës së specializuar teknike për audituesit në lidhje me interpretimin në raste komplekse të SNA dhe INTOSAI GOV

- 📄 Përsosja e mekanizmave të vlerësimit të riskut të brendshëm (inhernet) dhe teknikave të hetimit të riskut të mashtrimit dhe korrupsionit nga zyrtaret publike;
- 📄 Zhvillimi i aplikacioneve mbi sigurinë që merret nga evidencat, kampionet përfaqësuese, niveli i materialitetit sasior e cilësor si dhe dëshmitë e auditimit, nëpërmjet aplikimit të teknikave dhe metodave të përshtatshme gjatë një angazhimi profesional, varësisht tipologjisë së auditimit (përputhshmëri, financiar, IT, performance etj);
- 📄 Hartimi i manualeve dhe metodologjive për auditimin e emergjencave dhe fatkeqësive (kërkesa kjo dhe e ISSAI-ve), bazuar në fatkeqësinë e tërmetit të 26 nëntorit 2019 që kërcënoi me jete të humbura vendin tonë.
- 📄 Zhvillimi dhe avancimi në aplikimin e softwareve në funksion të auditimit (rasti ynë me SIMMPA), etj.

Ju faleminderit!

Bujar LESKAJ
KRYETAR I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

Prishtinë, 12 Shkurt 2020